



## Republika e Kosovës

Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



## Kuvendi i Komunës Istog

Skupština Opštine Istok  
Municipal Assembly Istog

Komitetit për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and Finance Committee

36	<b>P r o c e s v e r b a l</b>
<b>Tipi i mbledhjes:</b>	Mbledhje e rregullt e KPF-së
<b>Data e mbajtjes:</b>	24.05.2021 në ora 10:00
<b>Mbledhjen e kryesoi:</b>	Qaush Balaj, Kryesues i Kuvendit
<b>Procesmbajtës:</b>	Vjosa Hysenaj, Zyrtare e Lartë për Punë Profesionale të Kuvendit të Komunës së Istogut
<b>Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së</b>	Zenel Shatri, Haki Podrimaj, Besa Ferati, Eliot Kukiqi, Ajshe Metaj dhe Ardita Idrizaj
<b>Mungojnë:</b>	
<b>Pjesëmarrës të tjerë:</b>	Kryetari i Komunës z. Haki Rugova, Drejtorët: Drin Sadikaj, Enver Rugova, Hysni Maxharraj, Hazbi Bajraj, Edona Bujupi Logja, Lulzim Shoshi, Lulzim Blakaj, Zyrtar Administrativ: Zekie Sutaj, Ardon Arifaj, Flora Bujupaj, Jeta Balaj.
<b>Shqyrtimi i pikës 1.</b>	
<b>Diskutimet:</b>	
<b>Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj-</b> Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit, Konstatohet që prezent janë 7 anëtar te Komitetit për Politikë e Financa, Kuorumi është dhe mund të fillojmë me pikat në vazhdim.	
<b>Vendimet:</b>	
Vazhdojmë me mbledhjen	
<b>Personat përgjegjës për zbatim:</b>	Shërbimi për punë të kuvendit
<b>Afati për zbatim:</b>	Shërbimi për punë të kuvendit
<b>Rendi i ditës:</b>	
1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Komitetit,	
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të datës 23.04.2021,	

3. Njoftimi me Qarkoren Buxhetore 2022/24,
4. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2020,
5. Rishqyrtimi dhe marrja e Vendimit për aprovimin e Rregullores komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha,
6. Marrja e Vendimit për shfuqizimin e Vendimit Nr. 87/2015 të datës 30.10.2015 për lokacionin e varrezave në fshatin Vrellë,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-Vendimit për lokacionin e ri të varrezave në fshatin Vrellë,
8. Marrja e Vendimit për miratimin e propozim-vendimit për plotësim-ndryshimin e Vendimit 01-Nr./2014 të miratuar me datë 27.11.2014 në Kuvendin komunal -Istog për dhënien në shfrytëzim me negociim pronën e komunës investitorit Halit Avdijaj -pronar i "AGRO PRODUCT - SH.P.K".

**Diskutimet:**

**Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj** - përshëndeti të pranishmit, kushtet janë plotësuar për mbajtjen e kësaj mbledhje. Në mbrojtje të infektimit nga pandemia dhe respektimit të masave ndaj virusit Covid 19, Salla që jemi tani është dezinfektuar, anëtarët e komitetit si dhe të pranishmit tjerë janë pajisur me maska, dorëza dhe dezinfektues në tavolina.

Hapi punimet për këtë mbledhje me pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje.

Prezanton rendin e ditës,

Pyet nëse ka dikush ndonjë pyetje apo sugjerim para miratimit të rendit të ditës;

Pasi që nuk ka dikush diçka,

**Hedh në votim rendin e ditës.**

**Miratohet rendi i ditës unanimit.**

**Vendimet:**

**Miratohet rendi i ditës në mënyrë unanime.**

**Personat përgjegjës për zbatim:** Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:** Deri në mbledhjen e kuvendit

**Shqyrtimi i pikës 2.**

**Diskutimet:**

**Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj** - vazhdojmë më pikën e dytë të rendit të ditës: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni. a ka dikush diçka?

**Zenel Shatri** – kam vërejtje sepse nuk është shkruar e gjithë diskutimi im.

**Kryesuesi** – a ka dikush diçka tjetër

Pasi që diskutime nuk pati hedh në miratim .

Miratohet një zëri procesverbali nga mbledhja e kaluara me vërejtje.

**Vendimet:**

**Miratohen njëzëri procesverbali nga mbledhja e kaluar, pa vërejtje.**

<b>Personat përgjegjës për zbatim:</b>	Shërbimi për punë të kuvendit
<b>Afati për zbatim:</b>	Shërbimi për punë të kuvendit
<b>Shqyrtimi i pikës 3.</b>	
<b>Diskutimet:</b>	
<p><b>Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj</b> -vazhdojmë më pikën e tretë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe debatimi i Raportit financiar për periudhën Janar- Mars të vitit fiskal 2021, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës fjalën ja kaloj Drejtorit për Buxhet e Financa z. Hysni Maxharraj.</p> <p>Hysni Maxharraj- përshëndet të gjithë të pranishmit, prezanton dhe sqaron Njoftimi me Qarkoren Buxhetore 2022/24.</p> <p><b>Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj</b> – pasi qe diskutime nuk ka kalojmë në pikën e radhës</p>	
<b>Vendimet:</b>	
<p><b>Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja në mënyre unanime: Raportin financiar për periudhën Janar- Mars të vitit fiskal 2021, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim.</b></p>	
<b>Personat përgjegjës për zbatim:</b>	Shërbimi për punë të kuvendit
<b>Afati për zbatim:</b>	Deri në mbledhjen e kuvendit
<b>Shqyrtimi i pikës 4.</b>	
<p><b>Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj</b>, vazhdojmë më pikën e katërt të rendit të ditës: <b>Shqyr</b> <span style="border: 1px solid black; padding: 2px;">Formatted Table</span>          Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2020, raportin e keni pasur në material, prandaj unë rreth kësaj pike i jap fjalën Kryetarit z. Haki Rugova.</p> <p><b>Kryetari i Komunës z. Haki Rugova</b> – përshëndet të gjithë të pranishmit, benë prezantimin dhe sqarimin e Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2020 .</p> <p><b>Zenel Shatri</b> – përshëndet të gjithë të pranishmit, Pyete se ku ka arritur Komuna e Istogut me vaksinim dhe a po merren këto vaksina sipas moshës siç është rregull, apo si po veprohet në spital.</p> <p><b>Drejtori i Shëndetësisë , z. Mujë Osmanaj</b> - përshëndet të gjithë të pranishmit, vaksinimi është duke shkuar mirë sipas, sipas rregullit moshës, por kemi probleme me hapësire .</p> <p><b>Kryetari i Komunës z. Haki Rugova</b> – nuk dua tu jap shifra jo te sakta dua të dal vet në teren te shohë për se afërm se si po veprohet. Për hapsir mund ta shfrytëzoni hollin e Shtëpisë se Kulturës, nëse nuk ju mjafton ajo hapsir mund të shkoni në Palestër.          Rekomandoj nëse edhe ju pajtoheni komiteti që në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të hy si pikë e rendit të ditës Informata për gjendjen aktuale me Covid 19, ecuria e vaksinimit.          Që të jemi me transparent dhe me të informuar për ecurin e pandemis dhe vaksinimit në komunën e Istogut.</p> <p><b>Kryesuesi i Kuvendit</b> – pasi qe diskutime tjera nuk ka hedhe në miratim, me këtë Rekomandim Informata për gjendjen aktuale me Covid 19, ecuria e vaksinimit. Qe të hy pikë e rendit të ditës në mbledhjen e Kuvendit.          Kalon për KK nga anëtarët e KPF-së</p>	

<b>Diskutimet:</b>	
<b>Vendimet:</b>	
Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim me këtë Rekomandim: Informata për gjendjen aktuale me Covid 19, ecuria e vaksinimit, qetë hy pike e rendit të ditës në mbledhjen e Kuvendit.	
<b>Personat përgjegjës për zbatim:</b>	Shërbimi për punë të kuvendit
<b>Afati për zbatim:</b>	Deri në mbledhjen e kuvendit
<b>Shqyrtimi i pikës 5.</b>	
<b>Diskutimet:</b>	
Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj, po vazhdojmë më pikën e pestë të rendit të ditës, Rishqyrtimi dhe marrja e Vendimit për aprovimin e Rregullores komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba, lidhur me këtë fjalën ja kalojë Drejtorit për Buxhet e Financa z. Hysni Maxharraj.	
Hysni Maxharraj - përshëndet të gjithë të pranishmit, bënë prezantimin dhe sqarimin e Rishqyrtimi dhe marrja e Vendimit për aprovimin e Rregullores komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba.	
Kryesuesi i Kuvendit - pasi që diskutime tjera nuk ka hedhe në miratim Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së	
<b>Vendimet:</b>	
Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF unanim rekomandon që dhe të ia kalon KK për shqyrtim dhe miratim: Rishqyrtimi dhe marrja e Vendimit për aprovimin e Rregullores komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba.	
<b>Personat përgjegjës për zbatim:</b>	Shërbimi për punë të kuvendit
<b>Afati për zbatim:</b>	Deri në mbledhjen e kuvendit
<b>Shqyrtimi i pikës 6.</b>	
Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj, vazhdojmë më pikën e gjashtë të rendit të ditës Marrja e Vendimit për shfuqizimin e Vendimit Nr. 87/2015 të datës 30.10.2015 për lokacionin e varrezave në fshatin Vrellë, Edhe këtë material kemi pasur mundësi ta shikoni dhe ta analizoni, a dëshiron dikush fjalën.	
Haki Podrimaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, pyete këto prona qe po ipen a ka aty edhe prona private.	
Kryetari i Komunës z. Haki Rugova - nëse aty ka prona private ne nuk ndërhyrë aty ne e japim vetëm pronën e komunës, ne nuk jemi në dijeni nëse ka prona private aty.	
Faton Bujupaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, kjo qe po ipet është pronë e Komunës.	
Eliot Kukiqi - përshëndet të gjithë të pranishmit, pse po ndërrohet ky destinacion?	

**Kryetari i Komunës z. Haki Rugova** – Komitetit i fshatit Vrellë ka kërkuar që të behet ky ndërrim.

**Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj** –pasi që diskutime tjera nuk pati, konstatoj që Komiteti i rekomandon në mënyrë unanime të dërgoj për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Komunës Marrja e Vendimit për shfuqizimin e Vendimit Nr. 87/2015 të datës 30.10.2015 për lokacionin e varrezave në fshatin Vrellë .

**Vendimet:**

**Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF-ja unanime i rekomandon: Kuvendit të Komunës që të shqyrtim dhe miratim, Marrja e Vendimit për shfuqizimin e Vendimit Nr. 87/2015 të datës 30.10.2015 për lokacionin e varrezave në fshatin Vrellë.**

**Personat përgjegjës për zbatim:** Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:** Deri në mbledhjen e kuvendit

**Shqyrtimi i pikës 7.**

**Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj**, vazhdojmë më pikën e shtatë të rendit të ditës , Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-Vendimit për lokacionin e ri të varrezave në fshatin Vrellë, a dëshiron dikush fjalën rreth kësaj pike.

pasi që diskutime tjera nuk pati,

Hedhe në miratim Propozim-Vendimit për lokacionin e ri të varrezave në fshatin Vrellë, ti dërgohet për shqyrtim dhe miratim anëtareve të Kuvendit.

**Miratohet unanime**

**Diskutimet:**

**Vendimet:**

**Pasi që pati vërejte dhe diskutime të shumta , KPF-ja unanime rekomandon që : Propozim-Vendimit për lokacionin e ri të varrezave në fshatin Vrellë, t'i kalohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.**

**Personat përgjegjës për zbatim:** Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:** Deri në mbledhjen e kuvendit

**Shqyrtimi i pikës 8.**

**Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj**, vazhdojmë më pikën e tetë të rendit të ditës , Marrja e Vendimit për miratimin e propozim-vendimit për plotësim-ndryshimin e Vendimit 01-Nr./2014 të miratuar me datë 27.11.2014 në Kuvendin komunal –Istog për dhënien në shfrytëzim me negociim pronën e komunës investitorit Halit Avdijaj –pronar i “AGRO PRODUCT – SH.P.K”, fjalën ja kaloj Kryetarit të Komunës z. Haki Rugova.

**Kryetarit të Komunës z. Haki Rugova** –, bën prezanton dhe sqarimin e Propozim-Vendimit për plotësim-ndryshimin e Vendimit 01-Nr./2014 të miratuar me datë 27.11.2014 në Kuvendin komunal –Istog për dhënien në shfrytëzim me negociim pronën e komunës investitorit Halit Avdijaj –pronar i “AGRO PRODUCT – SH.P.K”.

<b>Faton Bujupaj</b> – bën njoftimin me skicat dhe vendin .	
<b>Haki Podrimaj</b> – kërkon që kjo pik të shtyhet për mbledhje e ardhshme, pasi qe ne nuk e kemi materialin.	
<b>Kryetarit të Komunës z. Haki Rugova</b> – pronari ketë pronë e ka kërkuar që katër vite.	
<b>Ardita Idrizaj</b> - përshëndet të gjithë të pranishmit, le të kaloj në Kuvend kjo pikë.	
<b>Ajshe Metaj</b> – edhe unë pajtohem qe të kaloj në kuvend, por edhe kontrata të vij në Kuvend.	
<b>Hazbi Bajraj</b> - përshëndet të gjithë të pranishmit, materiali për këtë pik është i gatshëm vetem skicat kanë mbetur sepse ende nuk janë punuar.	
<b>Zenel Shatri</b> – unë nuk jam i qartë me këtë pikë.	
<b>Kryetarit të Komunës z. Haki Rugova</b> – të Premten me datë 28.05.2021 në ora 14:00 të mbahet mbledhja e komitetit vetëm për këtë pike. Dhe materiali të përgatitet me së largu Enjten, në mënyrë që anëtarët e KPF-së të kenë mundësi ta analizojn materialin.	
<b>Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj</b> –pasi që diskutime tjera nuk pati, konstatoj që Komiteti i rekomandon në mënyrë unanime që të Premten me datë 28.05.2021 në ora 14:00 të mbahet mbledhja e komitetit vetëm për këtë pike. Miratohet unanimit.	
<b>Diskutimet:</b>	
<b>Vendimet:</b>	
Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF-ja rekomandon që : Propozim-Vendimit për plotësim-ndryshimin e Vendimit 01-Nr./2014 të miratuar me datë 27.11.2014 në Kuvendin komunal -Istog për dhënien në shfrytëzim me negociim pronën e komunës investitorit Halit Avdijaj –pronar i “AGRO PRODUCT - SH.P.K”, t’i kalohet Kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim.	
<b>Personat përgjegjës për zbatim:</b>	<b>Shërbimi për punë të kuvendit</b>
<b>Afati për zbatim:</b>	<b>Deri në mbledhjen e kuvendit</b>
<b>Diskutime tjera:</b>	
Kryesuesi i kuvendit z. Qaush Balaj, pasi që përfunduan pikat për këtë rend dite, ju falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë. Shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.	
<b>Mbledhja përfundoj :</b>	<b>13:10</b>

Procesmbajtëse,  
Znj. Vjosa Hysenaj

